



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RTK  
Nr. 1318/17  
Date 17.11.2017  
Prishtinë

**RREGULLOREPËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM**  
**NË MES TË**  
**BORDIT TË RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS**  
**DHE**  
**DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Prishtinë, Nëntor 2017**

## **BORDI I RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS PRISHTINË**

Në bazë të Nenit 29, par. 2 dhe nënparagrafit 2.2 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) Nr. 04/L-046, si dhe Nenit 17, par. 1, nënparagrafit 2, të Statutit të Radio Televizionit të Kosovës, Bordi i Radio Televizionit të Kosovës, nxjerr:

### **RREGULLOREN PËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM NË MES TË BORDIT TË RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS (RTK) DHE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË RTK-SË**

#### **Neni 1**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i mënyrës së komunikimit ndërmjet Bordit të RTK-së (në tekstin e mëtejshëm Bordi), dhe Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së (në tekstin e mëtejshëm DP).

#### **Neni 2**

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së i raporton Bordit së paku njëherë në muaj. Para çdo raportimi, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, obligohet që ta përcjellë me shkrim (e-mail) Raportin mujor të punës së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Bordit.
2. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, çdo tre muaj ia prezanton Bordit të RTK-së Raportin financiar të përpiluar nga Menaxhmenti i RTK-së. Raporti i prezantuar duhet të dorëzohet me shkrim (e-mail) në Bord së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
3. Bordi i RTK-së, në kuadër të angazhimeve të veta të rregullta, ka të drejtë të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm raportim për çështje specifike, për çka duhet ta njoftojë me shkrim Drejtorin së paku një javë para mbledhjes.
4. Në raste të veçanta, Bordi mund të kërkojë raportim nga Drejtori i Përgjithshëm për çështje të caktuara të jashtëzakonshme.

#### **Neni 3**

1. Drejtori i Përgjithshëm është personi brenda RTK-së i cili komunikon me Bordin.
2. Në raste të caktuara dhe me autorizim të DP, Bordit mund t'i raportojë ndonjë anëtar i Menaxhmentit të lartë.
3. Anëtarët e Bordit të RTK-së përkatësisht kryetarët e Komisioneve të Bordit, kërkesat e tyre për menaxhmentin dhe Drejtorin e Përgjithshëm i drejtojnë përmes Kryetarit të Bordit të RTK-së.

#### **Neni 4**

Drejtori i Përgjithshëm duhet të veprojë menjëherë pas marrjes së rekomandimeve dhe vendimeve në formë të shkruar nga ana e Bordit dhe lidhur me veprimet e ndërmarra ta njoftojë Bordin në mbledhjen e radhës.

#### **Neni 5**

Komunikimi ndërmjet Bordit dhe DP, me qëllim të përgatitjes së mbledhjeve apo me qëllim të përcjelljes së kërkesave të veçanta, përgatitjes për pjesëmarrje në takime të rëndësishme me faktorë të tjerë jashtë RTK-së dhe rasteve të tjera të rëndësishme të veçantë, zhvillohet ndërmjet Kryetarit të Bordit të RTK-së, anëtarëve të Bordit dhe DP.

#### **Neni 6**

Bordi i RTK-së mund të thërrasë secilin anëtar të Menaxhmentit për të raportuar në mbledhjet e Bordit për çështje të caktuara, duke ia drejtuar një kërkesë të tillë Drejtorit të Përgjithshëm.

#### **Neni 7**

Kryetari i Bordit të RTK-së, pas secilës mbledhje të Bordit, do t'ia dërgojë Drejtorit të Përgjithshëm me shkrim vendimet dhe rekomandimet e Bordit, jo më larg se tri ditë pune nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

#### **Neni 8**

Drejtori i Përgjithshëm e njofton Bordin e RTK-së në formë të shkruar për secilën iniciativë ad-hoc (teknologjike, programore, financiare, administrative etj.), që është në interes të RTK-së. Pas shqyrtimit, Bordi i RTK-së jep rekomandime për hapat e mëtejshëm.

#### **Neni 9**

1. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së e dërgon në Bord Projektionin buxhetor për vitin pasues deri më 30 shtator, i cili shqyrtohet nga Bordi, përcillet te DP me rekomandime dhe rikthehet në Bord për miratim.

2. Bordi i RTK-së e miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së, pasi të jetë përgatitur nga Menaxhmenti i RTK-së dhe është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

#### **Neni 10**

DP e dërgon në Bord Planprogramin vjetor në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së, siç është e përcaktuar me ligj, më së paku deri më 30 nëntor të vitit paraprak.

#### **Neni 11**

Drejtori i Përgjithshëm, më së largu deri më 28 shkurt, e dërgon Raporti vjetor për vitin paraprak në Bordin e RTK-së, i cili e shqyrton dhe publikon në ueb faqen e RTK-së, më së largu deri më 31 mars të çdo viti.

### **Neni 12**

Secili komunikim ndërmjet Bordit dhe DP, i cili zhvillohet jashtë mënyrave dhe procedurave të përshkruara në këtë Rregullore nuk prodhon efekt juridik.

### **Dispozitat kalimtare**

### **Neni 13**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja e saj, ndërsa e nënshkruan kryetari i Bordit të RTK-së.

**Prishtinë, 17 Nëntor 2017**

**Bordi i RTK-së, Afërdita Maliqi, kryetare**

  
\_\_\_\_\_